



TREGUESIT STATISTIKOR TË SHËRBIMEVE POSTARE

Tremujori III 2024

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore

Përmbajtje

I . HYRJE.....	3
II. PANORAMË E PËRGJITHSHME.....	3
III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE	5
1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare.....	5
2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare.....	8
3. Treguesit e e totalit të shërbimeve postare - Posta Shqiptare.....	9
4. Treguesit e shërbimit jo universal postar – P.SH dhe Ofruesit e tjerë	11
5. Treguesit e shërbimit ekspres - P.SH dhe Ofruesit e tjerë.....	11

I . HYRJE

AKEP, me qëllim informimin e palëve të interesuara me treguesit kryesore të tregut postar, sipas raportimeve të bëra nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar “Posta Shqiptare” sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare ka përgatitur këtë raport në të cilin evidentohen treguesit kryesor të tregut postar për tremujorin e tretë të vitit 2024, si edhe krahasimet me tremujorin e dytë të vitit 2024 dhe me tremujorin e tretë të vitit 2023, i cili publikohet në faqen e internetit të AKEP www.akep.al, në seksionin “Statistika rreth AKEP” - “Shërbimet Postare”.

Raporti ka natyrë periodike dhe përditësohet vazhdimisht me të dhënat statistikore të shërbimeve postare.

II. PANORAMË E PËRGJITHSHME

Në këtë raport statistikor janë paraqitur të dhënat periodike statistikore të shërbimeve postare për tremujorin e tretë të vitit 2024 të dërguara nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare të pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”, në zbatim të kërkesave të Rregullores Nr.40, Datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”.

Subjektet e pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare” të regjistruar në regjistrin e AKEP për periudhën e raportimit janë:

- **Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare sh.a.**
- **Ofruesit e shërbimeve postare (24 subjekte):**
 1. Air Cargo Service sh.p.k. (A.C.S.)
 2. Albanian Delivery Express sh.p.k.
 3. ALOPOST sh.p.k.
 4. BIPEX sh.p.k.
 5. DHL International (Albania) sh.p.k.
 6. Elite Post sh.p.k.
 7. EXPRESS ALB 24 sh.p.k.
 8. Fation Qama – Person fizik (Express City)
 9. GED sh.p.k. (ish B.E.D. sh.p.k.)
 10. GENIKI TAXYDROMIKI ALB sh.p.k
 11. Greenposta shpk
 12. INTEX COURIER sh.p.k.
 13. IPOST sh.p.k.
 14. Milsped Albania sh.p.k.
 15. Mr. COURIER sh.p.k.
 16. POSTA JONË sh.p.k.
 17. POSTMAN sh.p.k

18. T.N.T Express Albania sh.p.k.
19. Top Post sh.p.k.
20. Ultra C.E.P. sh.p.k.
21. Ulysses Enterprises sh.p.k.(Fedex)
22. United Transport sh.p.k. (Uni Trans)
23. Youth Albania Professional Services (YAPS);
24. ADEX sh.p.k

Gjatë periudhës, nga tremujori i dytë i vitit 2024 deri në tremujorin e tretë të vitit 2024, ka një subjekt të regjistruar për ofrimin e shërbimeve postare dhe kanë raportuar të dhënat statistikore 24 subjekte¹.

Posta Shqiptare me VKD Nr.13, datë 30.06.2020 është pajisur nga AKEP me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar.

¹ Ofrues të shërbimeve postare që kanë raportuar të dhënat statistikore në AKEP deri më datë 20.10.2024

III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE

Të dhënat statistikore postare të dërguara nga ofruesit e shërbimeve postare përmbajnë kryesisht:

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare;
2. Treguesit e shërbimit universal postar;
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar;
4. Treguesit e shërbimit ekspres.

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024 rezultojnë 6,660,683 objekte postare të pranuar dhe të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare, të dhëna në mënyrë më të detajuar paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela 1.1: Të dhëna përmbledhëse të objekteve postare sipas shërbimeve postare të ofruara

Shërbime postare të ofruara		T1_2023	T2_2023	T3_2023	T4_2023	T1_2024	T2_2024	T3_2024	Ndryshim T3_2024/ T2_2024	Ndryshim T3_2024/ T3_2023
Posta Shqiptare sh.a										
1	Shërbim Universal Postar									
1.1	Postë brenda vendit	5,351,099	3,679,866	4,098,479	4,522,704	4,727,732	4,942,119	4,844,980	-2%	18%
1.2	Postë ndërkombëtare	184,390	188,482	186,888	183,248	158,687	369,800	228,640	-38%	22%
1.3	Totali 1.1+1.2	5,535,489	3,868,348	4,285,367	4,705,952	4,886,419	5,311,919	5,073,620	-4%	18%
2	Shërbim jouniversal postar									
2.1	Postë brenda vendit	92,252	164,019	72,173	73,570	86,517	57,479	134,400	134%	86%
2.2	Postë ndërkombëtare	146	631	532	574	233	55	20	-64%	-96%
2.3	Totali 2.1+2.2	92,398	164,650	72,705	74,144	86,750	57,534	134,420	134%	85%
3	Shërbim ekspres									
3.1	Ekspres brenda vendit	126,129	126,802	129,033	109,818	117,001	113,575	116,750	3%	-10%
3.2	Ekspres ndërkombëtar	3,883	3,954	1,329	3,234	3,005	3,667	3,741	2%	181%
3.3	Totali 3.1+3.2	130,012	130,756	130,362	113,052	120,006	117,242	120,491	3%	-8%
Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare										
4	Shërbim JoUniversal Postar									
4.1	Postë brenda vendit	196,289	199,271	153,457	154,541	90,551	190,982	207,415	9%	35%
4.2	Postë ndërkombëtare	2,819	4,295	4,304	23,192	1,764	1,956	1,471	-25%	-66%
4.3	Totali 4.1+4.2	199,108	203,566	157,761	177,733	92,315	192,938	208,886	8%	32%
5	Shërbim ekspres									
5.1	Ekspres brenda vendit	712,332	679,269	689,710	825,031	825,844	833,005	931,372	12%	35%
5.2	Ekspres ndërkombëtar	63,387	104,757	119,519	123,551	136,049	154,756	191,894	24%	61%
5.3	Totali 5.1+5.2	775,719	784,026	809,229	948,582	961,893	987,761	1,123,266	14%	39%
6	Totali 1.3+2.3.3.3+4.3+5.3	6,732,726	5,151,346	5,455,424	6,019,463	6,147,383	6,667,394	6,660,683	0%	22%

Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Në mënyrë të përmbledhur në vijim paraqiten disa nga zhvillimet kryesore në këtë treg:

Posta Shqiptare (Ofrues i Shërbimit Universal)

- ✓ **Shërbim universal postar.** Ky zë në total ka pasur rritje në masën 18% nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës, ndërsa krahasuar me 3 mujorin e mëparshëm T2 2024 ka pasur një rënie në masën 4%. Edhe zëri **Postë brenda vendit** ka pasur rritje krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm në masën 18%, ndërsa krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm ka pasur një rënie në masën 2%. Gjithashtu, edhe zëri **Postë Ndërkombëtare** ka pasur një rritje në masën 22% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe një rënie me 38% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm T2 2024.
- ✓ **Shërbimi Jo universal postar.** Ky zë në total ka pasur rritje të konsiderueshme në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në masën 85% dhe me 134% në krahasim me 3-mujorin e mëparshëm T2 2024. Në të njëjtat nivele është dhe **Postë brenda vendit**. Ndërsa zëri **Postë ndërkombëtare** ka një rënie me 96% nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe me 64% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm T2 2024.
- ✓ **Shërbimi Ekspres** Ky zë në total ka pësuar rënie në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në masën 8%, ndërsa në krahasim me 3-mujorin e mëparshëm T2 2024 ka pasur rritje në masën 3%. Edhe shërbimi **Ekspres brenda vendit** ka pasur rënie në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në masën 10%, ndërsa në krahasim me 3-mujorin e mëparshëm T2 2024 ka pasur rritje në masën 3%, ndërsa zëri **Ekspres Ndërkombëtar** ka pasur rritje të konsiderueshme krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në masën 181%, dhe në masën 2% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm T2 2024.

Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare


- ✓ **Shërbimi Jo Universal Postar.** Ky zë ka një rritje në 3-mujorin e III 2024 në krahasim me 3-mujorin e II të 2024 në masën 8%, dhe në masën 32% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Edhe zëri **Postë brenda vendit** ka pasur rritje në krahasim me 3-mujorin e II të 2024 në masën 9%, dhe në masën 35% krahasuar me 3-mujorin III të vitit të kaluar. Ndërsa zëri **Postë ndërkombëtare** ka pësuar rënie në krahasim me 3-mujorin e mëparshëm T2 2024 në masën 25%, dhe në masën 66% në krahasim me 3-mujorin III të vitit të kaluar.
- ✓ **Shërbimi ekspres.** Ky zë ka pasur rritje në totalin e tij krahasuar me 3-mujorin e kaluar T2 2024 në masën 14%, dhe në masën 39% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Edhe zëri i shërbimit **Ekspres brenda vendit** ka pasur një rritje në masën 12% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm T2 2024 dhe në masën 35% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. E njëjta ecure evidentohet edhe për zërin e shërbimit **Ekspres ndërkombëtar**, i cili ka pasur rritje krahasuar si me 3-mujorin e mëparshëm T2 2024 ashtu edhe me të njëjtën periudhë të një viti më parë, përkatësisht në masat 24% dhe 61%.

Tabela 1.2: Totali i objekteve postare-Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T3 2024

Totali i objekteve postare		
	Objekte postare	Pjesë tregu
<i>P.Sh</i>	5,328,531	80%
<i>Of. e tjerë</i>	1,332,152	20%
Totali	6,660,683	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Grafiku 1.1: Totali i shërbimeve postare, krahasimi në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.1 më sipër, shikojmë një rënie në objektet postare në T3_2024 krahasuar me T2 2024 për Postën Shqiptare, ndërsa për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare kemi një rritje. Krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë kemi një rritje të totalit të objekteve postare për Postën Shqiptare dhe për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare.


Tabela 1.3: Totali i objekteve postare sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T3_2024

Sh.U	Sh. jo univers.	Sh.ekspres	Totali
5,073,620	343,306	1,243,757	6,660,683
76%	5%	19%	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Nga të dhënat e raportuara rezulton se volumin më të madh të objekteve postare e zë shërbimi universal postar me 76%, ndjekur nga shërbimi ekspres me 19% dhe shërbimi jo universal me 5 %.

Grafiku 1.2: Ecuria në 3-mujor sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.2, vërehet që pjesën më të madhe të shërbimeve postare e zë Shërbimi Universal Postar. Nga krahasimi i periudhës T3_2024 me periudhën T2_2024 vërehet që kemi një rënie të lehtë në masën 0.1% në volumin total të shërbimeve postare. Ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë evidentohet rritje në masën 22%.

2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare

Tabela 1.4: Shërbimi Universal Postar T3 2024


Shërbimi Universal Postar	
Postë brenda vendit	4,844,980
Postë ndërkombëtare	228,640
Totali	5,073,620

Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Nga të dhënat e tabelës 1.4 për T3 2024, për sa i përket shërbimit Universal Postar, vihet re se Posta Shqiptare realizoi gjithsej 5,073,620 objekte, nga të cilat posta brenda vendit zë 95% të objekteve postare dhe posta ndërkombëtare zë 5% të objekteve postare. Për sa i përket Shërbimit

Universal brenda vendit, janë regjistruar 4,134,541 shërbime për objekte të thjeshta dhe 710,439 shërbime për objekte të regjistruara/shërbime të veçanta. Në lidhje me Shërbimin Universal Postar Ndërkombëtar, janë regjistruar 56,538 objekte postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit dhe 172,102 objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri.

Grafiku 1.3: Shërbimi universal postar - Ecuria në 3 muajor



Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Nga grafiku i mësipërm, shikohet një rënie e shërbimit universal postar në T3_2024 krahasuar me T2_2024, me 4%.

3. Treguesit e totalit të shërbimeve postare - Posta Shqiptare

Në vijim paraqiten treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, të dërguara nga Posta Shqiptare:

Tabela 1.5: Treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, P. Sh


Llojet e shërbimeve	Nr. Objekteve	Pjesa tregut T_3 2024	Pjesa tregut T_3 2023
Shërbim universal postar	5,073,620	95.2%	95.5%
Shërbim jo universal postar	134,420	2.5%	1.6%
Shërbim ekspres	120,491	2.3%	2.9%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Nga të dhënat e Tabelës 1.5 vihet re se volumin kryesor në shërbimet postare, që ofron Posta Shqiptare e zë shërbimi universal me 95.2%, i ndjekur nga shërbimi jo universal postar me 2.5% dhe nga shërbimi ekspres 2.3%. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar kemi një rënie

të lehtë të Shërbimit jo universal postar, ndërsa Shërbimi universal postar dhe Shërbimi ekspres janë pothuajse në të njëjtat nivele.

Grafiku 1.4: Llojet e shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare – Ecuria në 3-mujor



Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Grafiku 1.4 paraqet ecurinë e objekteve postare të Posta Shqiptare, ku vihet re një rënie e shërbimit universal, dhe një rritje e atij jo universal dhe shërbimit ekspres në T3_2024 krahasuar me T2_2024.

4. Treguesit e shërbimit jo universal postar – P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim jepen të dhënat statistikore të marra së bashku për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për shërbimin jo universal.

Tabela 1.6: Shërbimi jo universal postar (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare)

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesë tregu T3_2024	Pjesë tregu T3_2023
P.Sh	134,420	39%	32%
Of. e tjerë	208,886	61%	68%
Totali	343,306	100%	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Grafiku 1.5: Shërbimi jo universal postar, Posta shqiptare/ofruesit e tjerë. Ecuria në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Për sa i përket shërbimit jo universal, objektet postare të realizuara në T3_2024 krahasuar me T2_2024 kanë pësuar rritje në total në masën 37% ku vërehet një rritje e ndjeshme prej 134% për Postën Shqiptare, dhe një rritje me 8% për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare.

Numri i objekteve të shërbimit jo-universal postar për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare gjatë T3 2024 përbëhet nga 341,815 objekte brenda vendit dhe 1,491 objekte për shërbimin jo-universal jashtë vendit.

5. Treguesit e shërbimit ekspres - P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim paraqitet informacion mbi treguesit e shërbimit postar ekspres për periudhën e tremujorit të tretë të vitit 2024, si edhe të dhënat për periudhat krahasuese për vitin 2023, mbi baza tremujore.

Tabela 1.7: Shërbimi ekspres-Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për T3_2024

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesë tregu T3_2024	Pjesë tregu T3_2023
P. Shqiptare	120,491	10%	14%
Of. e tjerë	1,123,266	90%	86%
Totali	1,243,757	100%	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Grafik 1.6: Shërbimi ekspres - Posta shqiptare/ofruesit e tjerë, Ecuria në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Shërbimi ekspres, gjatë T3_2024 ka pësuar rritje në krahasim me T2_2024 në masën 13% dhe me 32% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ndikimin më të madh në këtë rritje e kanë Ofruesit e tjerë.

Shërbimi ekspres brenda vendit për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë së bashku është në vlerën 1,048,122 objekte postare ose 84% e totalit të këtij shërbimi, ndërsa shërbimi postar ekspres ndërkombëtar në vlerën 195,635 objekte postare ose 16% e totalit të këtij shërbimi për periudhën raportuese.

Për sa i përket postës ndërkombëtare në shërbimin ekspres, sasia e objekteve hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri është në vlerën 161,697 objekte dhe sasia e objekteve postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit është në vlerën 33,938 objekte.